

Elsa Kareçi




PROKURORE PRANË PROKURORISË SË RREHIT TIRANË

Deklaratat e analizuara:

14 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2016)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2016



Pasuria para fillimit të detyrës është 0; Pasuria bruto me datë 31.12.2016 është 373,015,011 lekë.

+ 28,693,642 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë.

Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

Likuiditete në Bankë

185,692

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2016

Likuiditete në Cash

285,230

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2016

Pasuritë e Luajtshme

200,000

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2016

Pasuritë e Paluajtshme

10,101,349

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2016

Huadhënie

28,028,000

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2016

Pjesë në Kapital

334,214,740

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2016

Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2016	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga funksioni	12,347,908	51.5%
Të ardhura nga paga dhe aktiviteti privat i familjarëve	7,415,394	30.9%
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme	1,276,150	5.3%
Dhurata në Cash	27,046	0.1%
Të ardhura të tjera	2,916,280	12.2%
Total	23,982,778	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 13 vite rezultoi:

Pa Probleme

Në vitin 2003, subjekti Elsa Kareçi deklaroi të zotërojë 16.8% pjesë nga 18 dynym tokë përfutur nga ligji numër 7501, për të cilën nuk jep vendodhje apo vlerë aseti. Në vitin 2004, subjekti deklaroi të zotërojë 25% nga 400 m2 sipërfaqe truall ndërtimi me vlerë të deklaruar në 128,000 lekë si dhe 1/6 pjesë nga apartament banimi në vlerë 7,649 lekë blerë më 11.10.1995.

Në vitin 2014, bashkëjetuesi i subjektit deklaroi për herë të parë pasurinë, mes së cilave një shtëpi banimi në Tiranë të dhuruar nga prindërit, tokë bujqësore në Tiranë dhe në Bajzë të Shkodrës me vlerë respektive 30,000 euro dhe 50,000 USD si dhe aksione në shoqëritë "Shpata shpk", me kapital themeltar me vlerë 100,000 ALL si dhe "Miami Beach" me kapital themeltar me vlerë 334' 114' 740 lekë, ku zotëron 51% të aksioneve.

Në vitin 2014, bashkëjetuesi i subjektit deklaroi gjithashtu një hua me vlerë 200,000 euro të marrë në vitin 2008 për biznes si dhe një hua të dytë prej 200,000 eurosh nga fabrika e pasurimit të kromit në Bulqizë (në momentin e deklarimit janë shlyer 105,000 euro dhe 4,000,000 lekë).

